

Vendim nr. 184, datë 04.06.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 04.06.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (Th) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **THANAS KONDI**, përfaqësuar nga avokati Ilir Qafa, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-3481, datë 30.09.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 16, pika 2, 42, 131, shkronja “f”, 134 pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 49, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është trashëgimtari ligjor i shtetasve Filip Kondi dhe Vasillo Kondi (*prindërit e tij*). I ndjeri Filip Kondi ka qenë në marrëdhënie pune si teknik pyjesh në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Gjirokastrë (DSHP) deri në datën 10.01.2014, kur është larguar nga kjo detyrë. Për të kundërshtuar largimin nga puna, rezulton se i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë me kërkesëpadi për dhënien e dëmshpërblimeve që rrjedhin nga zgjidhja e pa shkaqe të arsyeshme të marrëdhënies së punës. Ajo gjykatë, me vendimin nr. 572, datë 25.09.2014, ka vendosur pranimin e pjesshërisht të kërkesëpadisë, detyrimin e palëve të paditura, Ministrisë së Mjedisit dhe DSHP-së, Gjirokastrë, ta dëmshpërblenin atë me: i) 10 muaj pagë për shkak të zgjidhjes së menjëhershme dhe të pajustificuar të marrëdhënies së kontratës së punës; ii) 3 muaj pagë për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit; iii) 2 muaj pagë për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës; iv) 35 paga 15-ditore për 35 vjet të plota pune. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 3366, datë 20.10.2016. Ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin 00-2023-3609, datë 14.09.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të Ministrisë së Mjedisit dhe të Turizmit.

2. Në vitin 2012 i ndjeri Filip Kondi ishte diagnostikuar me një sëmundje të rëndë, për shkak të së cilës ka ndërruar jetë në vitin 2016. Po kështu, për shkak të një sëmundjeje, në datën 07.10.2017 ka ndërruar jetë edhe nëna e kërkuesit, shtetasja Vasillo Kondi.

3. Në datën 26.06.2019 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me kërkesëpadi, për: i) detyrimin e Ministrisë së Turizmit dhe të Mjedisit për ta dëmshpërblyer atë për dëmin pasuror dhe jopasuror që kanë pësuar ai edhe prindërit e tij, si rezultat i veprimit të largimit të padrejtë nga puna të babait të tij; ii) shpenzimet e varrimit të babait të tij Filip Kondi.

4. Me vendimin nr. 3064 regjistri, datë 24.09.2019, gjykata e shkallës së parë ka vendosur mospranimin e padisë, duke e vlerësuar atë si të parashkruar, pasi ishte paraqitur tej afatit ligjor 3-vjeçar, të parashikuar në nenin 18, pika 4, të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*) dhe nenit 17 të ligjit nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore” të ndryshuar (*ligji nr. 8510/1999*). Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuesi.

5. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2020 (86-2024-2215), datë 21.11.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kjo gjykatë ka

arsyetuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë në përputhje me ligjin material dhe procedural, pasi padia e paraqitur nga kërkuesi është e parashkruar.

6. Për rekursin e kërkuesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-3481, datë 30.09.2025, ka vendosur mospranimin e tij. Ky kolegji ka vlerësuar se në rekursin e paraqitur nga kërkuesi nuk është parashtruar asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, për të cilat mund të ushtrohet e drejta e rekursit dhe se nuk është rasti as për të vënë në diskutim ndonjë çështje ligjore që mund të shqyrtohet kryesisht nga gjykata.

7. Në datën 11.03.2026, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pas plotësimit sipas kërkesave të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 01.04.2026. Ndërsa në datën 02.06.2026 Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pranimin e dorëheqjes së një anëtari të Kolegjit të Gjykatës dhe zëvendësimin e tij me tjetër gjyqtar.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, më mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

8.1. *Së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*, pasi gjykimi është zhvilluar në mungesë të kërkuesit.

8.2. *Parimi i kontradiktoritetit*, pasi gjykatat e zakonshme kanë marrë parasysh vetëm provat e palës së paditur, duke mos vlerësuar faktet e provat e paraqitura nga kërkuesi.

8.3. *Së drejtës së aksesit dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit nuk ka arsyetuar se përse rekursi nuk përmbante shkaqe ligjore për pranimin e tij.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose

juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Kolegji vëren se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

11. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, përcakton se Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 10, datë 04.03.2021; nr. 56, datë 25.07.2017; nr. 56, datë 21.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Lidhur me pretendimin e cenimit të *së drejtës për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur dhe parimit të kontradiktoritetit*, Kolegji vëren se kërkuesi nuk e ka ngritur atë përpara gjykatave të zakonshme dhe në ankimin kushtetues individual nuk ka evidentuar se në cilën shkallë të gjykimit i janë cenuar këto të drejta. Për rrjedhojë, për sa u përket pretendimeve për cenimin e *së drejtës për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur dhe parimit të kontradiktoritetit* nga gjykatat e faktit, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës. Ndërsa për sa i përket gjykimit të zhvilluar nga Gjykata e Lartë, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka mjete të tjera në dispozicion, përveç ankimit kushtetues individual.

13. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin konkret, rezulton se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi ka përfunduar me vendimin e datës 30.09.2025 të Gjykatës së Lartë, i cili, i sipas

informacionit elektronik të asaj gjykate, rezulton se është bërë i disponueshëm për palët në datën 22.01.2026, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 11.03.2026, pra brenda afatit ligjor. Për rrjedhojë, kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

14. Kolegji vëren se, për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës së aksesit dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues, ndaj do t'i shqyrtojë ato në vijim së bashku.

15. Për sa u përket pretendimeve për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur dhe parimit të kontradiktoritetit nga Gjykata e Lartë, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë argument në kuadër të këtij pretendimi. Në kushtet kur, siç jurisprudenca kushtetuese ka pranuar, gjykimi kushtetues është i natyrës argumentuese, që nënkupton se u takon palëve të parashtrajnë argumentet faktike dhe ligjore mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre (shih vendimet nr. 57, datë 25.07.2017; nr. 42, datë 25.05.2017; nr. 45, datë 29.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese), Kolegji vlerëson se këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim.

16. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, me argumentin se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit nuk ka arsyetuar se përse rekursi nuk përmban shkaqe ligjore për pranimin e tij.

17. Për sa i përket së drejtës së aksesit, në jurisprudencën e saj të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse ajo, përpara së gjithash, është kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (shih vendimin nr. 31, datë 03.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese). Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura (shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 17, datë 24.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese).

18. Gjykata, po ashtu, ka pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 12, datë 15.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese). Në tërësinë e tij vendimi gjyqësor duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe në funksion të njëra-tjetrës. Zbatimi i këtij standardi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të

çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 12, datë 28.02.2024; nr.12, datë 19.03.2015; nr. 33, datë 08.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket vendimeve të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, Gjykata ka theksuar se arsyetimi i kufizuar i tyre nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në këndvështrim të parashikimeve dhe të standardeve të mësipërme kushtetuese, në rastin konkret, Kolegji do të analizojë nëse Gjykata e Lartë i ka marrë në shqyrtim dhe u ka kthyer përgjigje pretendimeve të kërkuarit nëse në arsyetimin e saj ka ndonjë gabim aq të dukshëm ligjor ose faktik, të tillë që do të vinte në dyshim respektimin e së drejtës për një gjykim të drejtë.

20. Kolegji vëren se në datën 26.06.2019 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi për detyrimin e Ministrisë së Turizmit dhe të Mjedisit për ta dëmshpërblyer atë për dëmin pasuror dhe jopasuror që kanë pësuar ai edhe prindërit e tij si rezultat i veprimit të largimit të padrejtë nga puna të babait të tij, si dhe shpenzimet e varrimit. Pas shqyrtimi të kërkesëpadisë, ajo gjykatë ka vendosur mospranimin e saj. Ndër të tjera, ajo gjykatë ka vlerësuar se e drejta e kërkuarit për të kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vdekja e babait të tij është parashkruar në kuptim të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 17 të ligjit nr. 8510/1999, pasi padia është paraqitur tej afatit ligjor 3-vjeçar, që nga lindja e kësaj të drejte. Sipas gjykatës së shkallës së parë, për efekt të fillimit të parashkrimit të padisë për dëmin e pretenduar si të shkaktuar nga veprimet e palës së paditur referimi bëhet duke mbajtur në konsideratë kohën e vdekjes së babait të kërkuarit, datë 13.03.2016, ndërkohë padia është paraqitur nga ai në gjykatë më 26.06.2019. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuari.

21. Për ankimin e kërkuarit, Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se për shpërblimin e dëmit jopasuror të kërkuarit, për shkak të humbjes së prindërve të tij, referimi bëhet në ligjin e posaçëm nr. 8510/1999. Bazuar në nenin 17 të këtij ligji, kerkimi i shpërblimit të dëmit për dëmet e shkaktuara nga organet e administratës shtetërore parashkruhet brenda 3 vjetësh nga çasti kur i dëmtuari merr dijeni për dëmet e shkaktuara nga organet e administratës shtetërore. Me tej, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit.

22. Për sa i takon vendimit të Gjykatës së Lartë, që kundërshtohet nga kërkuesi në ankimin kushtetues individual, Kolegji vëren se ai tregon rrethanat e çështjes, vendimmarrjen e gjykatave të faktit, shkaqet e ngritura në rekurs (*shih paragrafin 4 të vendimit të Gjykatës së Lartë*), ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Me këtë arsyetim, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se rekursi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012 dhe ka vendosur mospranimin e tij (*shih paragrafin 6 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

23. Për sa më lart, Kolegji, duke iu referuar arsyetimit të gjykatave të zakonshme, konstaton se kërkuesi e ka ushtruar të drejtën e tij të paraqitjes së kërkesëpadisë, ku përmes një procesi gjyqësor, në të cilin janë përcaktuar faktet dhe është zbatuar ligji, është arritur në përfundimin se padia e tij ishte paraqitur jashtë afatit ligjor. Në rastin konkret, Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit kanë vlerësuar se e drejta e padisë së kërkuesit ka lindur nga momenti kur ka humbur jetën babai i tij në datën 13.03.2016, ndërsa kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datën 26.06.2019, pra jashtë afatit ligjor. Kolegji vlerëson se në rastin konkret, lidhur me momentin kur fillon të llogaritet afati i parashkrimit të padisë për shpërblimin e dëmit për humbjen e të atit dhe pas tij humbjen e nënës, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arsyetuar në mënyrë të drejtë dhe të mjaftueshme, duke përcaktuar si moment të fillimit të afatit të parashkrimit të padisë momentin kur babai i kërkuesit ka ndërruar jetë.

24. Po kështu, edhe Gjykata e Lartë, në ushtrim të funksionit të saj kushtetues, si gjykatë ligji, u ka dhënë përgjigje të mjaftueshme pretendimeve të kërkuesit. Vetëm fakti se ajo ka vendosur mospranimin e rekursit nuk i është i mjaftueshëm nga pikëpamja kushtetuese për të vënë në dyshim respektimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit, si aspekte të së drejtës për proces të rregullt ligjor. Kolegji vlerëson se në vendimet e gjykatave të zakonshme nuk rezulton të ketë ndonjë gabim aq të dukshëm ligjor ose faktik, që një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë dhe që ta bënte gjykimin të padrejtë. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e *së drejtës së aksesit* dhe të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* janë haptazi të pabazuara.

25. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk i plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.